



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HAS

Has më 03.06.2022

PROCES VERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM PËR TENDERIN ME OBJEKT:

“Shpenzime Rehabilitimi, Mirembajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime bashkia Has”

I mbajtur sot më datë 03.06.2022 në Has, nga ana e Njësisë së Prokurimit me qëllim zbardhjen e procesverbalit të argumentimit dhe miratimit të kërkesave të vecanta për kualifikim dhe specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, dhe ne referim te urdherit te prokurimit [Nr. 28, datë 16/05/2022](#), me të dhënat si vijon:

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Shpenzime Rehabilitimi, Mirembajtje Rruge Rurale dhe Kanalizime bashkia Has”

Lloji i procedurës: **E hapur e thjeshtuar**

Fondi limit: **5,740,833 (pesë milion e shtatëqind e dyzëmijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh**

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: **30 (tridhjetë) ditë**

Në bazë të nenit 21, pika 2<sup>1</sup>, të Ligjit [Nr. 162/2020](#) “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c<sup>2</sup> dhe nenit 78, pika 2<sup>3</sup>, të VKM [Nr. 285](#), datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia HAS**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76<sup>4</sup>, 82<sup>5</sup> dhe 83<sup>6</sup> të Ligjit [Nr. 162/2020](#) “Për prokurimin publik”, dhe nenin 26<sup>7</sup>, të VKM [Nr. 285](#), datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

*1 Autoriteti ose enti kontraktor*

*2 Dokumentimi i procesit, c) argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;*

*3 Neni 78, Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, 2.Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, .....*

*4 Kriteret detyruese për skualifikim*

*5 Kriteret detyruese për skualifikim*

*6 Sigurimi i ofertës*

*7 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*

## 2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

a) Sipas percaktimeve të bera në Shtojcën 7 të ketyre DT (**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit**) pikat: 1&2.

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- Vërtetim për xhiron minimale vjetore për vitet 2020 dhe 2021 në një vlerë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit që prokurohet (në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor).
- Kopje të vërtetuara të bilanceve të viteve ushtrimore 2020 dhe 2021 të konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse.
- Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2021, edhe detyrimet vendore për vitin 2022 (në rast se janë plotësuar afatet e maturimit të detyrimeve vendore për periudhën e mesipërme në përputhje me kërkesat e ligjit nr 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). nga njësitë e qeverisjes vendore ku ka pasur selinë e zhvillimit të aktivitetit dhe në të **gjitha niptet sekondare** që operatori ka në **QKB**. (Në rast të bashkimit të operatorëve ekonomikë secili anëtar i bashkimit duhet të paraqesë vërtetimin).

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pikat 1/a, 2 dhe 3<sup>8</sup>, të Ligjit [Nr. 162/2020](#) “Për prokurimin publik”, si dhe nenin 43<sup>9</sup>, të VKM [Nr. 285](#), datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e marzhit të xhiros së kërkuar në kufirin e përcaktuar si me sipër konsiderohet tregues i rëndësishëm për kapacitetin financiar të Operatorit Ekonomik Ofertues, duke marrë në analizë edhe faktin se vlera e fondit limit është e një kufiri të ulët dhe iu jep mundësinë ndër të tjera e dhe operatoreve ekonomik të vegjël dhe të mesëm të kenë akses në oferte.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Ligjit [Nr. 8438](#), datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave [Nr. 5](#), datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar si dhe VKM-së [Nr. 922](#) datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit [Nr. 8438](#), datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, Ligjin [Nr. 25/2018](#) datë 10.05.2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, të Ligjit [Nr. 9920](#), datë 19.5.2008” Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Neni 57), Ligjit [Nr. 10091](#) datë 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, si dhe VKM-së [Nr. 922](#) datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”

Kërkesa për shlyerjen e detyrimeve vendore i referohet kërkesave specifike të Ligjit [Nr. 9632](#) datë 30.10.2006, “Per Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

Përvojë e suksesshme në:

---

<sup>8</sup> Neni 77, Kërkesat për kualifikim

<sup>9</sup> Neni 43, Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, ose Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i fondit limit të kontratës që prokurohet.

a. Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me ente publike ofertuesi duhet të paraqesë:

Formularin e vleresimit, shoqëruar me:

Kontratë

Situacionin përfundimtar;

Aktin e kolaudit;

Çertifikaten e marrjes ne dorezim.

Faturat tatimore

b. Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat ofertuesi duhet të paraqesë:

Kontratë / vërtetime ku shënohet, vlera, koha dhe natyra e punës së bërë

Faturat tatimore përkatëse për çdo situacion.

Formular vlerësimi, shoqëruar me aktin e kolaudit dhe situacionin përfundimtar.

Leje ndërtimi të objektit.

Për kontratat e realizuara **si nënkontraktor**, ofertuesi duhet të paraqesë krahas dokumentacionit të mësipërm: dhe kontratën bazë ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë:

Pika **2.3.1/a** plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim.

Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Kurse pika **2.3.1/b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 (Kërkesat për kualifikim), të ligjit **Nr.** 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet), (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 5: Procedurë e hapur e thjeshtuar, pika 4 - Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave), të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më të vogël se vlera e (dyfishit të fondit limit) të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 3 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

**2.3.2** Operoret ekonomike duhet të dëshmojnë se disponojnë license profesionale për zbatim punimesh në ndërtim si dhe për kategorite e nevojshme për zbatimin e kontratës.

Për këtë duhet të paraqesin licensën perkate se të shoqërise, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave **Nr.** 42 date 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Liçensa profesionale e shoqërise, e vlefshme, me kategoritë:

- NP-1A Punime gërmimi në tokë;
- NP-7A Ujësjiellës, gazsjiellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje;

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit [Nr.162](#), datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM [Nr. 285](#), datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, (neni 39, pika 6/a), si dhe në Vendimin e Keshillit të Ministrave [Nr. 42](#) datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar.

Ofertuesi duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për zbatimin e kontratës. Numri mesatar i punonjësve dhe e stafit të jetë jo më pak se **20 (njëzet)** punonjës për periudhën Nentor 2021 – Prill 2022 (6 Muaj të fundit), të vërtetuar nga:

Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj në periudhën e lartpërmendur.

Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, të konfirmuar nga autoriteti përkatës.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit [Nr. 162](#), datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM [Nr. 285](#), datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, {neni 39, pika 6/c, ç)}, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Vendosija e këtij kriteri për fuqinë punetore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, i cili kërkon fuqi punetore të shtuar dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate.

1- Kandidati/ofertuesi duhet të ketë të punësuar dhe të përfshirë në licencën e shoqërisë për ekzekutimin e kësaj kontrate:

- Inxhinier ndertimi 1 (nje)

Për stafin e mësipërm të paraqiten: Kontratë punë të vlefshme; Diploma/certifikata; CV.

Të figurojnë në listëpagesën e shoqërisë për periudhën e përcaktuar si staf i shoqërisë.

*Operatori Ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se inxhinieret dhe punonjësit e kerkuar në pikën e mësipërme, janë të paangazhuar në kontrata të tjera.*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit [Nr. 162](#), datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM [Nr. 285](#), datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, {neni 39, pika 6/c)}, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

-Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se në listëpagesat e periudhës **Nentor 2021- Prill 2022** të rezultojnë të punësuar personelin teknik, të kualifikuar nga subjektet e licensuara për certifikimin e tyre si dhe të jenë të pajisur me kartela sigurie në punë të vlefshme i domosdoshëm për kryerjen e punimeve si më poshtë vijon:

## • 1 Manovrator

Ofertuesi duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga administratori i shoqërisë) drejtuesin teknik në objekt i cili duhet të jetë ing. i fushes, dhe të ketë eksperiencë pune. Drejtuesi teknik i të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

-Kontratë pune e vlefshme (përkatëse); -Diplomë; -CV

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit [Nr. 162](#), datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM [Nr. 285](#), datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, {neni 39, pika 6/c)},, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht:

Vendosja e këtij kriteri për fuqine punetore është bërë në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punetore të shtuar dhe me mjetet e kerkuara për zbatimin me sukses të kesaj kontrate.

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikata cilësie të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ku është akredituar ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA). Çertifikatat që kërkohen duhet të jenë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit:

- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë ISO 9001- 2015 (ose ekuivalente të vlefshme). *(Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)*
- Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë 45001-2018 (ose ekuivalente të vlefshme). *(Sistemi i Menaxhimit dhe Sigurisë në Punë)*

Në rastin e paraqitjes së ofertës nga një bashkim operatorësh, çertifikatat e mesiperme duhet të paraqiten nga secili prej operatorëve ekonomikë në përputhje me nenin 74, pika 3 *(Bashkimi i operatorëve ekonomikë, Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore)* të VKM [Nr. 914](#), datë 29.12.2014 “RPP” të ndryshuar.

Çertifikatat të jenë në gjuhën shqipe ose të përkthyer dhe të noterizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mesiperme është përcaktuar bazuar në nenin 79<sup>10</sup>, të ligjit [Nr. 162](#), datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM [Nr. 285](#), datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 44<sup>11</sup>.

**2.3.5** Ofertuesi duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Nr	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Eskavator me goma ose me zinxhire	në pronësi ose me qira	Cope 1
2	Fadromë 0.25 m <sup>3</sup>	në pronësi ose me qira	Cope 1
3	Kamionçine vetshkarkuse me kapacitet mbajtës 1.5 -2 ton	në pronësi ose me qira	Cope 1

<sup>10</sup> Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor

<sup>11</sup> Kërkesat e cilësisë

4	Kamiona mbi 7 ton	në pronësi ose me qira	Cope 3
---	-------------------	------------------------	--------

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:  
Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 2 copë

Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit (*i vlefshëm*); f) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit (*e vlefshme*), g) license e shoqerise per transport, i) foto ku të evidentohen dhe targat.

Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) certifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit (*i vlefshëm*); f) certifikatën për transport mallrash brënda vëndit (*e vlefshme*); Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit (*e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, qirasë ku të specifikohet objekti i prokurimi ne fjalet si dhe afati i saj*).

Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç'doganimit+urdher clirimi ose faturat tatimore te blerjes.

Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku afati të mbulojë periudhën e zbatimit të objektit.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.

*Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë te deklaruara ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktot. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi, ne rast se ofertuesi eshte bashkim operatoreve, çdo anetar i ketij bashkimi duhet te paraqese kete dokument)*

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77<sup>12</sup> të ligjit [Nr. 162](#), datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM [Nr. 285](#), datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtoare, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes

### **Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet Teknike per proceduren respektive jane hartuar nga subjekti i licensuar qe ka hartuar edhe projektin perkates te zbatimit duke qene elemente perberes te tij. Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit si dhe normat perkatese te Ligjit [Nr. 9290](#), date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe VKM [Nr. 312](#), datë 05.05.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e ligjit te Ligjit [Nr. 10480](#) datë 17.11.2011, "Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore". Specifikimet Teknike jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me*

<sup>12</sup> Kërkesat për kualifikim, 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa...



parashikimet e nenit 4, pika 38/b (38.“Specifikime teknike” janë:.... ) dhe nenit 36 (**Specifikimet teknike**) , të LPP, si dhe nenit 39 (Kërkesa të vecanta për kontratat për punë publike), pika 2 (Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për....), të VKM **Nr.** 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

#### Njesia Prokurimit

- |          |         |                                  |
|----------|---------|----------------------------------|
| - Erilda | Dibra   | Kryetar/Juriste                  |
| - Avni   | Muhadri | Anëtar /Pergj.Sek.Rrugeve Rurale |
| - Osman  | Morina  | Anëtar/ Tek Topograf             |